



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 370/5 prot.

Tiranë, më 11.05.2026

V E N D I M

Nr. 51, datë 11.05.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT
TË ECURISË DISIPLINORE NË INSTITUCIONIN E BASHKISË VLORË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Migena Canaj, në institucionin e Bashkisë Vlorë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresat nr.370 prot., datë 24.02.2026 dhe nr. 370/1 prot., datë 25.02.2026, të dërguara nga nëpunësja Migena Canaj, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Prokurimit, në Bashkinë Vlorë.

Komisioneri është njohur me pretendimet e nëpunëses, për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procedurës disiplinore, në përfundim të së cilës, me aktin nr. 03, (nr. 1840/4 prot.), datë 19.02.2026, “Për dhënien e masës disiplinore në shërbimin civil”, të Komisionit të Disiplinës, është dhënë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në ngarkim të saj.

Rezulton se si arsye për dhënien e masës disiplinore, janë paraqitur shkeljet e parashikuara në nenin 57, pika 2, geramat a), c), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreun II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Migena Canaj ka filluar procesin e verifikimit të informacionit. Njëpërmjet shkresës nr. 370/2 prot., datë 06.03.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacioneve të dërguara pranë Komisionerit me shkresat nr. 370 prot., datë 24.02.2026 dhe nr.370/1 prot., datë 25.02.2026, nga nëpunësja Migena Canaj”, Komisioneri ka informuar institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 4877/1 prot., datë 13.03.2026, me objekt: “Mbi kërkesën për dërgim dokumentacioni”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr.370/3 prot., datë 17.03.2026, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar, ku përfshihen aktet e administruara gjatë procedurës disiplinore të ndjekur për rastin në fjalë:

- Akti nr. 42 prot., datë 31.05.2024, i njësisë përgjegjëse, me anë të cilës nëpunësja Migena Canaj, është emëruar si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Prokurimit, në Bashkinë Vlorë;
- Akti i deklarimit “Për statusin e nëpunësit civil”, nr. 8951/1 prot., datë 09.06.2025, i njësisë përgjegjëse, me anë të cilës nëpunësja M. Canaj, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Prokurimit, në Drejtorinë Juridike, në Bashkinë Vlorë;
- Shkresa nr. 10491/1 prot., datë 30.06.2025, e Nënkryetarit të Bashkisë, dërguar APP-së, për vënie në dijeni lidhur me ndryshimin e personit përgjegjës për Njësinë e Prokurimit pranë Bashkisë Vlorë;
- Urdhëri i brendshëm nr. 61, datë 21.01.2026, i Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për caktimin e një prej personave përgjegjës M. Canaj, për prokurimet që do të zhvillohen për vitin 2026;
- Urdhëri i brendshëm nr. 264, datë 30.06.2025, “Për komandim në detyrë”, i Kryetarit të Bashkisë, përmes së cilit është urdhëruar që nëpunësja të kryejë procedurat e prokurimit, për Njësinë e Prokurimit;
- Urdhëri i brendshëm nr. 37 datë 16.01.2026 “Për ngritjen e Komisionit të Përhershëm Disiplinor në shërbimin civil për nivelin ekzekutiv”, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë;

- Urdhëri i brendshëm nr. 87 datë 28.01.2026, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil për Znj. Migena Canaj”, ti Kryetarit të Bashkisë Vlorë, si dhe aktet e emërimit të anëtarëve të Komisionit Disiplinor;
- Shkresa nr. 1840/1 prot., datë 09.02.2026, “Njoftim për fillim procedure disiplinore”, i Komisionit Disiplinor;
- Shkresa nr. 1840/2 prot., datë 12.02.2026, “Dërgim sqarimesh në mbështetje të shkresës nr. 1840/1 prot., datë 09.02.2026 të Komisionit Disiplinor”, i nëpunëses Migena Canaj;
- Procesverbal i seancës dëgjimore i nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës, protokolluar me nr. 1840/3 prot., datë 13.02.2026, në Bashkinë Vlorë;
- Vendimi nr. 03, (nr.1840/4 prot.), datë 19.02.2026, “Për dhënie mase disiplinore në shërbimin civil”, i Komisionit Disiplinor;

Sa i takon objektit të kërkesës që ka lidhje me institutin e disiplinës në shërbimin civil, me të cilën nëpunësja i është drejtuar Komisionerit, sqarojmë se, ligji për nëpunësin civil ka parashikuar si detyrim ligjor, zhvillimin e një tërësie veprimesh procedurale, të cilat duhet të zbatohen sipas rendit të përcaktuar në kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit në fjalë, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, si dhe në udhëzimin e DAP-it, me nr. 01, datë 21.01.2025, “Mbi organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, me aktin e emërimit nr. 8951/1 prot., datë 09.06.2025, të njësisë përgjegjëse, nëpunëses Migena Canaj, i është deklaruar statusi si nëpunës civil, në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Prokurimit, në Drejtorinë Juridike, në Bashkinë Vlorë.

Në vijim të marrëdhënies së punës në këtë pozicion, duke ju referuar rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ushtruar në Bashkinë Vlorë, në ngarkim të nëpunëses, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ka nisur ecuria disiplinore.

Në përfundim të këtij procedimi disiplinor, me aktin nr. 03, (nr. 1840/4 prot.), datë 19.02.2026, “Për dhënien e masës disiplinore në shërbimin civil”, të Komisionit të Disiplinës, në ngarkim të nëpunëses Migena Canaj është dhënë masë disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për shkelje të parashikuara në nenin 57, pika 2, geramat a), c) të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të këtij rasti, Komisioneri është informuar nga institucioni i Bashkisë Vlorë, se nëpunësja në fjalë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, duke paraqitur edhe Fletë-Thirrjen nr. 1859, (31155-00514-89-2026), me datë regjistrimi 17.03.2026, më palë paditëse Migena Canaj dhe me palë të paditur institucionin e Bashkisë Vlorë, me objekt: “Shfuqizim Vendimi”.

Nisur nga gjithë sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar, në përmbajtje të së cilit sanksionohet se, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të trajtojë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se, Komisioneri nuk mund të vijojë më tej, procesin e hetimit të kësaj procedure disiplinore, pasi kjo mosmarrëveshje është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të së cilit do të jepet zgjidhje përfundimtare pas trajtimit në themel të rastit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 16, pika 6), e Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit me shkresat nr. 370 prot., datë 24.02.2026 dhe nr. 370/1 prot., datë 25.02.2026, të paraqitur nga nëpunësja Migena Canaj, përse i takon objektit të kërkuar për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur për dhënien e masës disiplinore, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Vlorë, si dhe nëpunësja Migena Canaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)